



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZL. Anr.425/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër aktivistit Naman nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, për Kryetar Komune të mbajtura më datë 09 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2025, merr këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET e pa bazuar** ankesa ZL.Anr.425/2025, e datës 09.11.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër aktivistit Naman nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, për Kryetar Komune të mbajtura më datë 09 Nëntor 2025.

## **A r s y e t i m**

Me datën 09.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.425/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 09.11.2025, në orën 13:00, ditën e heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, aktivistët e LVV në Prishtinë kishin vërejtur se në portalin Kosovanews.com ishte publikuar një bisedë telefonike në mes gazetarit Jeton Sopu dhe një personi me emrin Naman dhe numër kontaktues +38345504356 i cili ishte prezantuar si aktivist i Partisë Demokratike të Kosovës dhe i njëjti kishte kërkuar nga gazetari që ditën e zgjedhjeve ta votoj kandidatin e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës për kryetar të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama me pretendimin se ky është qëndrim i PDK-së.



Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës theksohet se personi i përmendur në ankesën e LVV-së nuk është zyrtar i PDK-së dhe nuk ka asnjë lidhje me të. Nga emri "Namani" as nuk mund të identifikohet se kush është konkretisht. E gjithë kjo duket si një improvizim, andaj kërkojnë nga PZAP që ta hedhë poshtë ankesën, pasi nuk ekziston asnjë provë e qartë se ky person është zyrtar i PDK-së.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, si dhe përgjigje në ankesë ka gjetur se:

- *Ankesa është e pabazuar*

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, paneli vlerësoi se pretendimet ankimore të ankuesit subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, lidhur me shkeljen e pretenduar se aktivisti nga radhët e subjektit politik PDK, z. Naman, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, janë të pabazuara për faktin se e njëjti nuk ka arritur që të vërtetoj, përkatësisht të dëshmoj faktin se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë të vetme dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj se se aktivisiti me emrin Naman nuk mund të vërtetohet që është zyrtar apo përkrahës i PDK-së. Kurse pretendimet e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se "PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht" dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: "PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë", lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh "Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme". Andaj Paneli vlerësoi pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pabazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi për z. Naman të cilit i referohet pala ankuese, Paneli erdhi në përfundim që nuk është anëtarë, aktivist apo mbështetës i PDK-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse". Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i

ankesës, nuk mund të vërtetohet se kush është personi me emrin Naman, cilit subjekt i takon për të cilën referohet pala ankuese, në ndërkohë që me provat tjera është vërtetuar se ne rrjetin social në Facebook, gazetari Jeton Sopa e ka postuar si aktivist të PDK-së.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Kështu që Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, konstatoi se dëshmitë e ofruara nuk janë të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se pretendimi i parashtrueses se ankesës se personi me emrin Naman, cilit subjekt i takon për të cilën referohet pala ankuese, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, andaj në rrethanat e rastit konkret ankesa është refuzuar si e pa bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.425/2025, datë 12.11.2025



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.